

KAPITULLI I GJASHTË

**DASHURIA DO TË
SJELLË BASHKIMIN**

Fuqia e fesë për t'i kthyer njerëzit drejt mirësisë



Më 2 gusht, 1990, Presidenti i Irakut, Saddam Huseini, push-toi Kuvajtin duke nderur shkëndijën e luftës në Gjirin Per-sik. Kjo zonë ka qenë me kohë si fuçi baruti, dhe mund ta shihja se bota ishte gati të përfshihej në vorbullën e luftës. Arrita në konkluzionin, se udhëheqësit e krishterë dhe myslimanë duhet të takoheshin për të ndaluar konfliktin. Veprova menjëherë duke bërë gjithçka munda për të ndaluar një luftë, që, me siguri, do të merrte jetët e shumë njerëzve të pafajshmëve.

Më 2 tetor unë thirra, papritmas, një konferencë urgjente të Këshillit të Feve Botërore në Kajro të Egjiptit, për t'i dhënë mesazhin tim urgjent të paqes autoriteteve më të larta shpirtërore të Lindjes së Mesme dhe të botës myslimane. Shumë vetë u habitën; pse unë, një person që në pamje të jashtme nuk kisha lidhje me Lindjen e Mesme, thërrisja një takim të tillë. Por për mua ishte e thjeshtë. Unë besoj se çdo fe duhet të kontribuojë në paqen botërore. Një konflikt midis krishterimit dhe islamizmit do të ishte shumë më i ashpër se konflikti midis demokracisë dhe komunizmit. Nuk ka gjë më të frikshme se lufta fetare.

Unë i dërgova presidentit Xhorxh W. Bush, i cili tashmë po përpiqej ta kufizonte konfliktin, një mesazh ku i lutesha të shmangte luftën në

botën arabe dhe, në vend të saj, të punonte për të realizuar tërheqjen e Sadam Husseinit në rrugë diplomatike. Presidenti Bush mund të mendonte se po hapte luftë kundër Irakut, por nuk do të mendonte të njëjtën gjë bota myslimane. Për myslimanët, feja qëndron në një pozitë më të lartë se kombi. Isha shumë i shqetësuar se, nëse do të sulmohej Iraku, bota arabe do t'i kundërvihej Shteteve të Bashkuara dhe botës së krishterë.

Konferenca jonë e jashtëzakonshme në Kajro përfshiu udhëheqës myslimanë dhe myftinj të mëdhenj nga nëntë kombe, duke përfshirë edhe myftiun e madh të Sirisë dhe Jemenit. Thelbi i takimit ishte apeli im, i dëshpëruar, ndaj botës arabe dhe myslimane për të mos mbështetur pretendimin e Sadam Husseinit se kjo ishte një luftë e shenjtë. Nëse fitonin Shtetet e Bashkuara apo Iraku, ç'të mirë do të sillte kjo gjë? Çfarë vlere do të kishte nëse bombat do të binin si shi, duke shkatërruar shtëpi, shkolla dhe jetë të pafajshme, që janë aq të çmuara?

Konferenca e Kajros ishte një prej aktiviteteve tona të shumta për paqen. Sa herë janë shfaqur kriza në Lindjen e Mesme, anëtarët tanë kanë punuar pa iu trembur syri, duke rrezikuar jetën në terren të minuar. Për vite me radhë, gjatë dhunës dhe terrorit në Izrael dhe Palestinë, anëtarët tanë kanë udhëtuar sapo u është kërkuar për të bashkëpunuar me organizatat kryesore për paqen.

Jam gjithmonë në ankth sa herë i dërgoj anëtarët në vende ku jeta e tyre është në rrezik, por kjo është e pashmangshme kur punohet për çështjen e paqes. Mund të jem në Brazil duke punuar tokën nën diellin e nxehtë, ose duke folur në Afrikën e largët, por zemra vazhdimisht më shkon tek ata anëtarë, që punojnë me këmbëngulje në fuçinë e rrezikshme të barutit të quajtur Lindje e Mesme. Lutem që paqja të vijë shpejt në botë e të mos kem nevojë t'u kërkoj anëtarëve tanë të shkojnë në të

tilla vende të vdekjes.

Më 11 shtator 2001, të gjithë e ndiemë tmerrin e madh, kur “kullat binjake” të Qendrës së Tregtisë Botërore në Nju Jork u shkatërruan nga terroristët. Disa thanë se kjo ishte përleshja e pashmangshme e civilizimeve midis islamizmit dhe krishterimit. Por unë kam tjetër pikëpamje. Në formën e tyre më të pastër, islamizmi dhe krishterimi nuk janë fe të konfliktit dhe përleshjes, të dyja i vënë rëndësi paqes. Sipas meje, është fanatizëm të emërtosh të gjithë myslimanizmin si radikal, ashtu sikurse është sektare të thuash se islamizmi dhe krishterimi janë esencialisht të ndryshëm. Thelbi i të gjitha feve është i njëjtë.

Menjëherë pas rënies së kullave, unë organizova udhëheqës fetarë nga Nju Jorku dhe anëmbanë vendit për t’u lutur e ndihmuar viktimat dhe ata, që ndihmuan fillimisht. Pastaj në tetor, thirra një konferencë të madhe ndërfaqetare për paqen në qytetin e Nju Jorkut. Kjo ishte mbledhja e parë ndërkombëtare në Nju Jork, pas tragjedisë.

Këto kontribute të menjëhershme për paqen, në kohëra lufte, nuk buruan nga hiçi. Për dekada të tëra unë kam investuar në përkrahjen dhe nxitjen e harmonisë ndërfaqetare. Vetëm mbi bazën e këtij investimi kemi fituar besimin e udhëheqësve të besimeve kryesore, që mundën të udhëtonin në Izrael gjatë Intifadës, apo në Nju Jork, pas 11 shtatorit.

Në vitin 1984, mblodha dyzet dijetarë fetarë dhe i udhëzova të krahasonin mësimet që jepeshin në tekstet e shenjta të krishterimit, të islamizmit, të budizmit dhe të feve të tjera të mëdha të botës. Libri që doli si rezultat i përpjekjeve të tyre ishte “Shkrime të shenjta botërore: një antologji krahasuese e teksteve të shenjta”, botuar në vitin 1991. Nga puna e tyre u zbulua se tekstet e shenjta transmetojnë mësimet e njëjta, ose të ngjashme në më shumë se 70 për qind të tyre. Pjesa që mbetet, prej 30 për qind, janë mësimet që përfaqësojnë çështje unike të çdo feje.

Kjo do të thotë se shumica e mësimeve të feve të mëdha botërore janë të njëjta në thelbin e tyre. Kjo është e vërtetë dhe për ritet fetare. Nga ana e jashtme disa besimtarë mbajnë çallmë, disa mbajnë rruaza lutje rreth qafës, të tjerë mbajnë kryqin, por ata, të gjithë, kërkojnë të vërtetat themelore të universit dhe përpiqen të kuptojnë vullnetin e Hyjit.

Njerëzit shpesh bëhen miq, madje, edhe sikur të kenë të përbashkët vetëm një hobi të caktuar. Kur dy të panjohur takohen dhe zbulojnë se kanë të njëjtën vendlindje, ata komunikojnë menjëherë, njëlloj sikur ta kenë njohur njëri-tjetrin prej dhjetëra vitesh. Prandaj është me të vërtetë tragjike që fetë, që kanë të njëjtat mësime në më shumë se 70 përqind të rasteve, ende e kanë të vështirë të kuptojnë njëra-tjetrën dhe të komunikojnë me kënaqësi. Ato mund të flasin rreth gjërave të përbashkëta dhe mund të kapen për dore me njëra-tjetrën. Në vend të kësaj, theksojnë ndryshimet dhe kritikojnë njëra-tjetrën. Të gjitha fetë në botë flasin rreth paqes dhe dashurisë. Megjithatë, luftojnë me njëra-tjetrën për paqen dhe dashurinë. Izraeli dhe Palestina flasin rreth paqes dhe drejtësisë, por, prapëseprapë, të dyja palët praktikojnë dhunën, derisa fëmijët plagosen dhe vdesin.

Judaizmi, feja e Izraelit, është fe e paqes, dhe e njëjta gjë është e vërtetë edhe për islamizmin. Përvoja jonë nga hartimi i “Shkrimeve të shenjta botërore”, na udhëheq të besojmë se nuk janë gabim fetë e botës, por mënyrat se si ato mësohen. Mësimi i gabuar i besimit sjell paragjykimë, dhe paragjykimi të çon në konflikt. Myslimanët u damkosën si terroristë pas sulmit të 11 shtatorit. Por shumica e këtyre familjeve të thjeshta besimtare janë njerëz që e duan paqen ashtu si ne.

I ndjeri Jaser Arafat udhëhoqi palestinezët për një kohë të gjatë. Si të gjithë udhëheqësit politikë, ai pati ëndërruar për paqen, por gjithashtu emri i tij u lakua në lidhje me konfliktin e këtij rajoni. Si kryetar i Orga-

nizatës për Çlirimin e Palestinës, Arafati mishëronte vendosmërinë që Rripi i Gazës dhe Bregu Perëndimor të bëhej shtet i pavarur palestinez. Shumë argumentojnë se ai u shkëput nga lidhjet e së kaluarës dhe filloi t'i ndalonte veprimtaritë e organizatave ekstremiste, pasi u zgjodh president i Autoritetit Kombëtar Palestinez, në vitin 1996. Në interes të kërkimit të paqes në Lindjen e Mesme, komunikova me Arafatin në dymbëdhjetë raste të veçanta. Natyrisht, fjalët e mia nuk ndryshuan kurrë. Rruga e Zotit është gjithnjë rruga e harmonisë që kërkon paqen.

Rruga për tek zyra e Arafatit ishte me të vërtetë e vështirë. Kushdo që i afrohej zyrës së tij duhet të kalonte përmes rojeve të armatosura rëndë dhe duhet t'u nënshtrohej të paktën tri kontrolleve trupore gjatë rrugës. Por, kur shkonin anëtarët tanë, Arafati i mirëpriste krahëhapur, i veshur me kefejhun (çallmë tradicionale) e tij. Këto lloj marrëdhëniesh nuk mund të ndërtohen në një apo dy ditë. Ato vijnë nga vitet kur derdhëm gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin tonë për hir të paqes në Lindjen e Mesme. Ishin përpjekjet e zjarra dhe gatishmëria e vazhdueshme për të rrezikuar jetën në mes të zonave të konflikteve plot terror, që përgatitën rrugën në sajë të së cilës të mirëpritëshim në marrëdhëniet me udhëheqësit fetarë dhe politikë në këto nivele. Na u desh të shpenzonim pasuri të mëdha për këtë. Përfundimisht, mundëm të fitojmë besimin e të dyja palëve, të Arafatit dhe të udhëheqësve të parë të Izraelit, gjë që na lejoji të luajmë një rol ndërmjetësues gjatë shpërthimit të konfliktit në Lindjen e Mesme.

Shkela për herë të parë në Jeruzalem në vitin 1965. Kjo ishte para Luftës Gjashtë Ditore, dhe Jeruzalemi ishte ende nën kontrollin territorial të Jordanisë. Shkova në Malin e Ullinjve, vendi ku Jezusi derdhi lot gjaku në lutje, pak para se të çohet në gjyqin e Ponc Pilatit. Vura dorën mbi ullirin dymijë vjeçar, që mund të ketë qenë në lutjen e Jezusit atë natë. Ngula tri gozhdë në atë pemë: një për judaizmin, një për krishteri-

min dhe një për islamizmin. U luta për ditën kur këto tri familje besimi të bëhen një. Paqja botërore nuk mund të vijë po qe se judaizmi, krishterimi dhe islamizmi nuk bëhen një. Ato tri gozhdë vazhdojnë të jenë atje.

Sot judaizmi, islamizmi dhe krishterimi janë të ndarë rreptësisht me njëri-tjetrin, por ata kanë rrënjë të përbashkëta. Çështja që i mban të ndarë është mënyra se si e kuptojnë Jezusin. Për t'iu vënë seriozisht këtij problemi, më 19 maj 2003, u kërkova të krishterëve të hiqnim theksin nga kryqi në marrëdhëniet me besimet abrahamike. Kështu, kryem një ceremoni të uljes së kryqit. Morëm një kryq nga Amerika, një kulturë ku dominon krishterimi, dhe e varrosëm atë në Fushën e Gjakut në Izrael. Kjo është fusha që u ble me tridhjetë monedhat e argjendit, që Juda Iskarioti mori për tradhtinë ndaj Jezusit, gjë që çoi në kryqëzimin e tij.

Më vonë, në po të njëjtin vit, më 23 dhjetor, rreth 3000 Ambasadorë për Paqen, nga të gjitha fetë dhe nga e gjithë bota, u bashkuan me 17000 izraelitë dhe palestinezë në Parkun e Pavarësisë në Jerusalem për të hequr simbolikisht kurorën me gjemba nga koka e Jezusit dhe për ta zëvendësuar atë me një kurorë të paqes. Më pas ata marshuan për paqen përmes Jerusalemit. Autoritetet lokale na dhanë leje dhe i mbrojtën përpjekjet tona, ndërsa familjet palestineze dhe izraelite e mbështetën marshimin tonë për paqe duke vendosur një dritë në portat e shtëpive të tyre.

Në saje të atij marshimi, i cili u transmetua drejtpërdrejt nëpërmjet internetit në mbarë botën, deklarova se Jezusit i ishte rikthyer autoriteti i tij si Mbret i Paqes. Pas shekuj keqkuptimesh dhe ndarjesh, ishte krijuar një shans që krishterimi, judaizmi dhe islamizmi të pajtoheshin me njëri-tjetrin.

Xhamia Al-Aksa, e treta për nga shenjtëria në islamizëm, pas asaj të Mekës dhe të Medinës, ndodhet në Jerusalem. Në atë vend thuhet se pro-

feti Muhamed është ngjitur në qiell. Grupi ynë ishte i vetmi grup besimtarësh të përzier, i mirëpritur në të gjitha cepat e kësaj shtëpie adhurimi. Drejtuesit e xhamisë i shoqëruan udhëheqësit e krishterë dhe ata hebrenj, që kishin marrë pjesë në marshimin e paqes, në vendet e shenjta brenda xhamisë. Ne qemë në gjendje të hapnim një derë, e cila kishte qenë mbyllur fort, dhe përgatitëm rrugën që shumë udhëheqës myslimanë të komunikonin në nivel të ri me vëllezërit dhe motrat e tyre të krishterë dhe hebrenj.

Qeniet njerëzore e pëlqejnë paqen, por njëkohësisht edhe konfliktin. Qeniet njerëzore marrin kafshët më të buta dhe i nxisin që të përleshen. Ata i bëjnë këndesat të përleshen dhe të çukisin njëri-tjetrin me sqepat e tyre të mprehtë, deri sa të fillojë t'u bjerë mishi copa-copa. Pastaj, po ata njerëz kthehen dhe u thonë fëmijëve të tyre: “Mos u zini me shokët. Luani siç duhet”.

Arsyeja thelbësore pse ndodhin luftërat nuk është as feja dhe as raca. Është e lidhur më atë çka ndodhet thellë brenda qenieve njerëzore. Njerëzve u pëlqen t'ia atribuojnë shkaqet e konflikteve të armatosura gjërave të tilla, si shkencës apo ekonomisë, por problemi themelor aktual ndodhet brenda nesh, qenieve njerëzore.

Roli i fesë është t'i kthejë qeniet njerëzore drejt mirësisë dhe të eliminojë natyrën e keqe të tyre, që gjen kënaqësi tek luftërat. Studioni fetë më të mëdha të botës. Të gjitha ato e mbajnë botën paqësore si idealin e tyre. Të gjitha dëshirojnë të shikojnë një mbretëri të qiellit, utopinë apo parajsën. Besimet fetare kanë emra të ndryshme për këtë ideal, por të gjitha e kërkojnë një botë të tillë. Ekzistojnë fe të shumta në botë dhe, pothuajse, të gjitha janë të ndara në fraksione dhe degëzime të panumërta. Por shpresa kryesore që të gjitha ato kanë është e njëjtë: ato duan Mbretërinë e Qiellit dhe një botë të paqes. Zemra e njeriut është bërë copë e thërrime nga dhuna dhe armiqësia që kemi në thelb. Mbretëria e dashurisë do ta shërojë atë.

Lumi nuk i pengon ujërat që rrjedhin drejt tij



Egoizmi në këtë botë është i shfrenuar. Sidoqoftë, është ironike që individ i po shkatërrohet pikërisht nga kjo dhe, jo thjesht individ, por edhe gjërat rreth tij; madje edhe kombi i tërë. Pengesa më e madhe për botën e paqes është koprracia në zemrën e njerëzve. Ajo fillon tek individët dhe përhapet në komb; zemrat e njollosura me koprraci shkaktojnë ndarje dhe konflikte në çdo nivel. Njerëz të panumërt gjatë historisë kanë derdhur gjak dhe kanë vdekur në konfliktet e shkaktuara nga zemërngushtësia.

Për të zhdukur konflikte të tilla na nevojitet një revolucion i madh, që të ndryshojë vlerat dhe mendimet e gabuara të përhapura anembanë, në botën e sotme. Problemet komplekse me të cilat përballet sot shoqëria mund të zgjidhen shpejt, nëse ka një revolucion në mënyrën e të menduarit të njerëzve. Nëse çdo individ dhe çdo komb fillon të kujdeset për tjetrin së pari, duke punuar së bashku me tjetrin, problemet e shoqërisë moderne do të zgjidhen.

Gjithë jetën ia kam dedikuar përpjekjeve për paqen. Sa herë dëgjoj të flitet për paqen, emocionohem. Sytë më mbushen, zëri më dridhet dhe mezi përtypem. Prekem thellë, vetëm kur imagjinoj ditën kur bota do të bëhet një dhe do të fillojë t'i gëzohet paqes. Kjo është natyra e paqes.

Ajo lidh njerëzit që mendojnë ndryshe, që janë nga raca të ndryshme dhe që flasin gjuhë të ndryshme. Zemrat tona mezi e presin atë botë, dhe ushqejnë shpresën se ajo do të realizohet.

Megjithatë paqja vjen përmes veprimit konkret; jo duke pasur një ëndërr e turbullt. Krijimi i një lëvizjeje për paqen nuk ka qenë gjithmonë i lehtë. Ka pasur shumë vështirësi, dhe janë dashur shuma të mëdha parash. Nuk e kam bërë këtë për nderin apo lavdinë time dhe as për të fituar para. Gjithë ç'kam bërë ka qenë investimi i të gjitha përpjekjeve, në mënyrë që të kemi një botë ku një paqe e vërtetë dhe e qëndrueshme të zërë vend. Sa kohë që kam bërë këtë punë, nuk kam qenë kurrë i vetëm. Sepse, përfundimisht, paqja është dëshira e çdo njeriu në botë. Mirëpo, është për t'u çuditur; të gjithë e duan paqen, por ajo ende nuk është arritur.

Është e lehtë të flasësh për paqen. Por ta sjellësh paqen nuk është e lehtë. Kjo ndodh sepse njerëzit lënë mënjanë të vërtetën më elementare, që nevojitet për të sjellë një botë të paqes. Ata bëjnë sikur nuk e dinë që ekziston kjo e vërtetë. Para se të flasim rreth paqes ndërmjet individëve apo ndërmjet kombeve, duhet të flasim rreth paqes ndërmjet nesh dhe Zotit.

Çdo fe, sot, e mendon veten si më e larta, duke refuzuar dhe përçmuar fetë e tjera. Nuk është e drejtë të ndërtosh mure përballë feve dhe degëve të tjera.

Një fe është tamam si një lumë i gjerë, që rrjedh drejt një bote ideale paqësore. Lumi rrjedh nëpër një rrugë të gjatë, derisa arrin në hapësirën e gjerë të paqes. Gjatë rrugës, shumë përrenj bashkohen me të. Përrenjtë ndalojnë së qeni përrenj në çastin që takojnë lumin. Që nga ai çast, edhe ata bëhen pjesë e lumit. Në këtë mënyrë bëhen një.

Lumi nuk refuzon asnjë nga përrenjtë që bashkohen me të. I pranon

të gjithë. I përqafojnë të gjithë përrenjtë dhe formon një rrjedhë të vetme, ndërkohë që vazhdon rrugën drejt oqeanit. Njerëzit, sot në botë, nuk e kuptojnë këtë të vërtetë kaq të thjeshtë. Përrenjtë, që kërkojnë lumin dhe bashkohen me të, janë fetë dhe degëzimet e tyre të shumta. Të gjithë përrenjtë vijnë nga burime të ndryshme, por të gjithë shkojnë në të njëjtin stacion. Ata kërkojnë botën ideale, të tejmbushur me paqe.

Paqja nuk do të vijë kurrë në këtë tokë po të mos shembim, së pari, muret midis feve. Për mijëra vjet, fetë janë rritur në aleancë me grupe etnike të veçanta, prandaj edhe janë të rrethuara nga mure të larta kulturore. Shembja e tyre është një detyrë jashtëzakonisht e vështirë. Për mijëra vjet, secila fe e ka rrethuar veten me këto mure kaq të larta, duke ngulur këmbë se është e vetmja fe e drejtë. Në disa raste, fetë e kanë përhapur ndikimin e tyre dhe kanë hyrë në konflikte dhe luftëra me fetë e tjera, duke përdorur emrin e Zotit, për gjëra që nuk kanë pasur të bëjnë fare me vullnetin e Tij.

Vullneti i Zotit gjendet te paqja. Një botë e ndarë në dallime kombëtare, racore dhe fetare, ku njerëzit sulmojnë, luftojnë njëri-tjetrin dhe përgjaken, nuk është bota që dëshiron Zoti. Kur luftojmë dhe përgjakim njëri-tjetrin në emër të Tij, i shkaktojmë Atij vetëm dhimbje. Një botë e bërë copë e thërrime është pasojë e dëshirës së njerëzve për të shtuar pasurinë apo lavdinë e tyre. Kjo nuk përfaqëson vullnetin e Zotit. Zoti ma ka thënë qartë këtë gjë. Unë jam veç çiraku i Tij, që merr fjalët e Tij dhe i shpërndan ato në Tokë.

Rruga për të sjellë një botë të paqes, në të cilën fetë dhe racat të bashkohen, ka qenë rraskapitëse. Shumë herë jam refuzuar nga njerëzit, ose fuqitë më kanë shteruar, por nuk mund ta lija mënjane këtë mision. Madje, i kisha zili kur anëtarët dhe kolegët, që punonin me mua, qanin në ankth për shkak të detyrës së vështirë. “Nëse vendosni që kjo rrugë

nuk është për ju, keni shansin të ndaloni dhe të ktheheni,- u thosha. Ose, nëse përpiqeni dhe përpiqeni dhe prapë nuk e përmbushni, keni shansin të vdisni duke u përpjekur. Por ju duhet t'ju vijë gjynah për mua,- u thosha. - Unë jam një njeri që nuk i ka këto mundësi zgjedhje”.

Ka rreth dyqind shtete në botë. Që, të gjitha këto vende të gëzojnë në paqe fuqia e fesë është absolutisht e nevojshme. Fuqia e fesë është në dashurinë që rrjedh prej saj. Jam njeri fetar, roli i të cilit është të transmetojë dashuri, prandaj është e natyrshme të punoj për paqen botërore. Nuk ka asnjë ndryshim midis islamizmit dhe krishterimit, për sa i përket vendosmërisë për të sjellë një botë të paqes. Në Amerikë, ku udhëheq një lëvizje për paqen, kam bërë së bashku mijëra klerikë që kanë kapërcyer degëzimet fetare. Nëpërmjet kësaj lëvizjeje ne diskutojmë mënyrat sipas të cilave njerëz nga të gjitha fetë si: krishterimi, islamizmi, budizmi, etj. mund të afrohen. Ia kushtojmë të gjitha përpjekjet tona zbutjes së zemrave të ngurtësuar të njerëzve.

Qëllimi që kam sot është i njëjtë me atë që kisha dje. Është të krijoj një botë me Zotin në qendër të saj, një botë të bashkuar si një komb i vetëm, pa kufij. Gjithë njerëzit do të jenë qytetarët e kësaj bote, dhe nuk do të ketë mundësi për ndarje dhe konflikte. Kjo do të shënojë fillimin e një bote me të vërtetë paqësore.

“Lejo lirinë e besimit në Bashkimin Sovjetik”



Ekzistojnë një sërë teorish të njohura, të bazuara tek materializmi, por jo të vërtetuara. Njëra është teoria e evolucionit, e Çarls Darvinit. Një tjetër teori e ngjashme vjen nga shkrimet e Karl Marksit. Ideja se shpirti e ka origjinën tek materia është e gabuar që në rrënjë. Qeniet njerëzore u krijuan nga Zoti, dhe të gjitha qeniet janë trupa të bashkuar me të dyja aspektet, materiale edhe shpirtërore. Me pak fjalë, thelbi i teorisë dhe filozofisë mbi të cilin qëndron komunizmi i gabuar. Kur studioja në Japoni, bashkëpunoja me komunistët për pavarësinë e Koresë. Ata ishin shokët e mi të ngushtë, që ishin gati të jepnin edhe jetën, nëse do të ishte e nevojshme, për çlirimin e atdheut, por kishim mënyra të menduari tërësisht të ndryshme. Prandaj, sapo u arrit pavarësia, rrugët tona u ndanë.

Jam kundër materializmit historik të komunizmit. Kam krijuar një lëvizje për fitoren kundër komunizmit në mbarë botën. Kam këshilluar presidentë të njëpasnjëshëm të ShBA-ve që të mbrojnë botën e lirë, duke u ngritur kundër strategjisë komuniste për të kthyer të gjithë botën në të kuqe. Vendet komuniste, të inatosura me veprimet e mia, kanë tentuar të më heqin qafe nëpërmjet veprimeve terroriste, por unë nuk i urrej ata. Nuk i konsideroj as si armiqtë e mi. Jam kundër filozofisë dhe ide-

ologjisë së komunizmit, por nuk i kam urryer kurrë njerëzit e tij. Zoti dëshiron që të gjithë njerëzit, përfshirë dhe komunistët, të përfshihen në unitetin e Tij.

Në këtë kuptim, vizita ime në Moskë, në prill të vitit 1990, për t'u takuar me presidentin Mihail Gorbaçov, dhe vizita ime në Penian vitin që pasoi, për t'u takuar me presidentin Kim Il Sung, nuk ishin udhëtime të thjeshta; i ndërmora ato duke vënë në rrezik jetën time. Për mua ishte e paracaktuar që t'i bëja ato udhëtime për t'u transmetuar atyre burrave vullnetin e Qiellit. E thashë gjysmë me shaka në atë kohë që "Moskë, e shqiptuar në anglisht, tingëllon si "must go" (duhet të shkoj), prandaj shkova.

Për një kohë të gjatë kisha brenda meje një bindje për komunizmin. Kisha mundur të parashikoja se shenjat që tregonin rënien e komunizmit do të fillonin të shfaqeshin rreth gjashtëdhjetë vjet pas revolucionit bolshevik dhe se ndërtesa sovjetike do të binte në vitin 1987, në shtatëdhjetëvjetorin e Revolucionit. Prandaj isha i emocionuar më 1984-ën, kur dëgjova se dr. Morton Kaplan, një analist politik i shquar në Universitetin e Çikagos, kishte propozuar të organizonte një konferencë ndërkombëtare me titull "Rënia e perandorisë sovjetike". I kërkova të vinte të më vizitonte në burgun Denbëri, në mënyrë që të diskutonim në detaje. Gjëja e parë që i thashë, kur u takuam, ishte se doja që ai të deklaronte fundin e komunizmit sovjetik- para 15 gushtit të atij viti.

Dr. Kaplan u përgjigj: "Të deklaroj fundin e komunizmit sovjetik? Si mund ta bëj një gjë kaq të rrezikshme?". Dhe tregoi se nuk ishte i prirë ta bënte këtë. Në vitin 1985, viti kur do të zhvillohej konferenca, Bashkimi Sovjetik po e shtonte ndikimin e vet në mbarë botën dhe nuk kishte asnjë shenjë të dukshme e cila të tregonte rënien e tij. Por zjarri, afër fundit, ndriçon më shumë. Prandaj ishte e natyrshme që dr. Kaplan të

ngurronte. Nëse ai do të bënte një deklaratë që parashikonte një ngjarje kaq specifike dhe, nëse dilte e rreme, reputacioni i tij si akademik do të shkatërrohej brenda një nate.

“Rev. Mun,- tha ai,- ju besoj kur thoni se komunizmi sovjetik do të bjerë. Por nuk mendoj se do të ndodhë kaq shpejt. Prandaj, në vend që të deklarojmë ‘fundin e komunizmit sovjetik’, po sikur të themi ‘tatëpjeta e komunizmit sovjetik?’”. Kur e shihja që propozonte të zbuste titullin e programit të tij dhe të përdorte diçka të ndryshme nga “rënia e perandorisë sovjetike”, zieja nga inati. Ky ishte një kompromis që nuk mund ta pranoja. E ndjeva thellë që, nëse një person ishte i bindur, duhet të merrte guximin të përdorte të gjitha energjitë për të luftuar, megjithëse mund të ndihej i frikësuar.

“Dr. Kaplan,- i thashë,- çfarë doni të thoni? Kur ju kërkoj të deklaroni fundin e komunizmit, e kam një arsye. Dita kur ju deklaroni fundin e komunizmit, ajo deklaratë në vetvete, do t’i shterojë energjitë e tij dhe do të ndihmojë që përmbysja të jetë paqësore. Pse po hezitoni?”

Si përfundim, dr. Kaplan në fakt deklaroi “fundin e komunizmit” në një konferencë të Akademisë së Profesorëve për Paqe Botërore (APPB), të zhvilluar në Gjenevë, nën titullin: “Rënia e perandorisë sovjetike: e ardhmja e tranzicionit të një bote post sovjetike”. Kjo ishte diçka që askush nuk kishte marrë guximin ta shqyrtonte. Ngaqë Zvicra ishte një vend neutral, Gjeneva ishte zonë kryesore vendqëndrimi për Komitetin Sovjetik të Sigurimit të Shtetit (KGB), dhe shumë agentë të KGB-së punonin nga aty për të kryer veprimtari spiunazhi dhe terrori nëpër botë. Hoteli “Interkontinental”, ku u zhvillua konferenca e APPB, ishte përballë ambasadës sovjetike, në anën tjetër të rrugës, kështu që e imagjinoj sa nervoz do të jetë ndier dr. Kaplan. Megjithatë, disa vite më vonë, ai u bë i mirënjohur si studiuesi që parashikoi për herë të parë fundin e

komunizmit sovjetik.

Në prill të vitit 1990, thirra Konferencën Botërore të Medias, që u zhvillua në Moskë. Papritur, qeveria sovjetike më bëri një pritje sipas protokollit që ndiqet për krerët e shteteve, duke filluar që në aeroport. Në udhëtimin drejt qendrës së Moskës, u shoqëruam nga një varg makinash të policisë. Makina ku isha unë ecte në zonën e verdhë të rrugës, që përdorej vetëm për presidentin dhe për të ftuarit e shtetit. Kjo ndodhi para përmbysjes së Bashkimit Sovjetik. Qeveria sovjetike rezervoi këtë trajtim të veçantë për mua, një antikomunist.

Në konferencë mbajta një fjalim në të cilin lavdërova lëvizjen drejt perestrojkës. Thashë se ky revolucion duhet të bëhet pa gjakderdhje dhe se duhet të jetë një revolucion i mendjes dhe i shpirtit. Qëllimi i vizitës sime ishte të ndiqja Konferencën Botërore të Medias, por mendja më rrinte te takimi me presidentin Gorbaçov.

Në atë kohë, presidenti Gorbaçov kishte fituar popullaritet brenda Bashkimit Sovjetik në saje të suksesit të politikave të tij të perestrojkës. Gjatë këtyre viteve, qeshë në gjendje të takohesha me shumë presidentë të SHBA-së, por takimi me presidentin Gorbaçov ishte shumë më i vështirë. Shqetësohesha se, ndoshta, mund të ishte vështirë të realizohej edhe një takim i vetëm. Kisha për t'i dhënë një mesazh, dhe ishte e rëndësishme t'ia jepja personalisht. Ai ishte duke reformuar Bashkimin Sovjetik, duke bërë që atje të frynin erërat e lirisë, por, me kalimin e kohës, shpatat e reformës po drejtoheshin gjithmonë e më shumë tek ai. Nëse situata do të dilte jashtë kontrollit, ai mund të vihej në një rrezik të madh.

Unë u shpjegova: “Nëse ai nuk më takon mua, do të humbë shansin për të kapur valët e fatit qiellor dhe, nëse nuk i kap ato, nuk e ka të gjatë”.

Ndoshta presidenti Gorbaçov e dëgjoi këtë shprehje të shqetësimit

tim. Të nesërmen, ai më ftoi në Pallatin e Kremlinit. Hipa në një limuzinë të sjellë nga qeveria sovjetike dhe u futa në zemër të Kremlinit. Pasi hymë në zyren presidenciale, gruaja ime dhe unë u ulëm në vendet tona, ndërsa ministrat e kabinetit të Bashkimit Sovjetik zunë vendet pranë nesh. Presidenti Gorbaçov buzëqeshi me krenari dhe na dha një shpjegim energjik për suksesin e politikave të tij të *perestrojkës*. Pastaj më çoi në një paradhomë ku ndenjëm vetëm për vetëm. Unë e përdora këtë mundësi për t'i dhënë mesazhin e mëposhtëm:

“Zoti President, ju keni arritur tashmë një sukses të madh nëpërmjet *perestrojkës*, por vetëm ajo nuk do të jetë e mjaftueshme për reformën. Ju duhet të lejoni menjëherë lirinë e besimit në Bashkimin Sovjetik. Nëse përpiqeni të reformoni vetëm botën materiale, pa përfshirjen e Zotit, *perestrojka* është e sigurt që do të dështojë. Komunizmit po i vjen fundi. E vetmja mënyrë për të shpëtuar këtë komb është lejimi i lirisë së besimit. Ka ardhur koha që ju të veproni me kurajën, që keni treguar gjatë reformimit të Bashkimit Sovjetik dhe të bëheni një president që punon për të sjellë paqen botërore”.

Fytyra e Presidentit Gorbaçov u ashpërsua, kur dëgjoi të përmendet liria fetare, sikur të mos e priste një gjë të tillë. Megjithatë, siç mund të pritej nga një burrë që disa muaj më parë kishte lejuar ribashkimin e Gjermanisë, e zbuti menjëherë shprehjen e fytyrës dhe, i përmbajtur, pranoi fjalët e mia. Vazhdova duke i thënë: “Koreja e Jugut dhe Bashkimi Sovjetik duhet të vendosin marrëdhënie diplomatike. Në këtë kup-tim, ju lutem, ftojeni për vizitë presidentin e Koresë së Jugut, Roh Te Vu”. I shpjegova gjithashtu një sërë arsyesh pse do të ishte mirë që dy vendet të kishin marrëdhënie diplomatike. Pasi kisha mbaruar gjithçka doja të thosha, presidenti Gorbaçov më premtoi me një ton të sigurt, të cilin nuk ia kisha dëgjuar më parë.

“Kam besimin,- tha ai,- se marrëdhëniet midis Koresë së Jugut dhe Bashkimit Sovjetik do të zhvillohen qetësisht. Edhe unë besoj se stabiliteti politik dhe qetësimi i tensioneve në Gadishullin Korean është i nevojshëm. Hapja e marrëdhënieve diplomatike me Korenë e Jugut është vetëm çështje kohe; nuk ka asnjë pengesë. Siç më sugjeruat ju, unë do të takoj presidentin Roh Te Vu”.

Atë ditë, kur po ndaheshim me presidentin Gorbaçov, hoqa orën dhe ia vura në dorë. U duk pak si i habitur që po e trajtoja sikur ta kisha shok të vjetër. Atëherë i thashë prerazi: “Sa herë reformat e tua të hasin vështirësi, të lutem, shikoni këtë orë dhe kujtoni premtimin që më keni bërë. Nëse vepron kështu, Qielli me siguri do të hapë një rrugë për ty”.

Ashtu siç premtoi, presidenti Gorbaçov u takua me presidentin Roh në San Francisko, në qershor të atij viti, gjatë një takimi dypalësh. Pastaj, më 30 shtator 1990, Koreja e Jugut dhe Bashkimi Sovjetik firmosën një marrëveshje historike për të lidhur marrëdhëniet diplomatike, për herë të parë, pas tetëdhjetë e gjashtë vitesh. Sigurisht, politika është punë e politikanëve dhe diplomacia është punë e diplomatëve. Megjithatë, nganjëherë, kur një derë ka qenë e mbyllur për një kohë të gjatë, një njeri besimtar, që nuk rrezikon asnjë interes personal, mund të jetë më efektiv.

Katër vjet më vonë, presidenti dhe znj. Gorbaçov vizituan Seul. Unë dhe gruaja ime i pritëm në rezidencën tonë, në lagjen Hannam Dong. Në atë kohë ai kishte rënë nga pozita ,nga një grusht shteti. Pas grushtit të shtetit, të organizuar nga forcat anti-reformiste që kundërshtonin perestrojkën, ai dha dorëheqjen nga pozita e tij si sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste Sovjetike dhe e shkriu partinë. Si komunist, ai e kish eliminuar Partinë Komuniste. Ish-presidenti dhe gruaja e tij hëngrën, me shkopinj, bulgogi (mish i rrahur dhe i skuqur) dhe çapçe

(makarona orizi me perime), që i kishim përgatitur me kujdes. Kur i shërbyen suxhongua si ëmbëlsirë (një pije freskuese e bërë nga hurma), z. Gorbaçov tha disa herë: “Koreja ka ushqim të shkëlqyer”. Ai dhe zonja e parë, dukeshin të qetë dhe shumë ndryshe nga kohët e tensionuara, kur ai ishte në pushtet. Zonja Gorbaçov, e cila më parë kishte qenë një marksist leniniste radikale, që jepte mësim në Universitetin Shtetëror të Moskës, kishte vënë një varëse me kryq.

“Z. President, ju keni bërë një gjë madhështore,- i thashë.- Ju dhatë dorëheqjen nga posti i sekretarit të përgjithshëm të Partisë Komuniste Sovjetike, por tani jeni bërë president i paqes. Në saje të zgjuarsisë dhe kurajës tuaj, tani kemi mundësi të sjellim paqen botërore. Ju keni bërë gjënë më të rëndësishme, më të përjetshme dhe më të bukur në botë. Jeni një hero i paqes, që ka bërë punën e Zotit. Emri që do të mbetet përgjithmonë në historinë e Ruisë nuk do të jetë ai i Marksit, Leninit apo Stalinit. Do të jetë ai i Mihail Gorbaçovit”.

I dhashë një vlerësim kaq të lartë vendimit të z. Gorbaçov për të sjellë shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, mëmëdheun e komunizmit, pa gjakderdhje.

Duke u përgjigjur, z. Gorbaçov tha: “Rev. Mun, më kanë ngushëlluar jashtëzakonisht shumë fjalët e tua. Fjalët e tua më japin energji. Do t’ia kushtoj pjesën e jetës që më ka mbetur për projektet e paqes botërore”. Dhe më shtrëngoi fort dorën.

Bashkimi i Koresë do të sjellë bashkimin e botës



Ndërsa po dilja nga Pallati i Kremlinit, pas takimit me z. Gorbaçov, u ktheva nga Bo Hi Pak, shoqëruesi im, dhe i dhashë një udhëzim të veçantë.

“Duhet të takoj presidentin Kim Il Sung para fundit të vitit 1991,- i thashë.- Koha nuk pret. Bashkimi Sovjetik po shkon drejt fundit brenda një ose dy viteve. Vendi ynë është problemi tani. Në një farë mënyre, duhet të takoj presidentin Kim dhe të parandaloj shpërthimin e luftës në gadishullin korean.”

E dija që, kur të përmbysej Bashkimi Sovjetik, shumica e regjimeve të tjera komuniste në botë do të përmbyseshin gjithashtu. Koreja e Veriut do ta gjente veten të rrethuar në një qoshe, dhe nuk mund të shprehet me fjalë provokimi që mund të ndërmernte. Fiksimi i Koresë së Veriut pas armëve bërthamore e bënte situatën edhe më shqetësuese. Për të parandaluar një luftë me Korenë e Veriut, na nevojitej një linjë komunikimi, nëpërmjet të cilës të flisnim me udhëheqjen e saj, por në atë çast nuk kishim një linjë të tillë. Në një farë mënyre, duhej të takoja presidentin Kim dhe të merrja prej tij premtimin që të mos sulmonte i pari Korenë e Jugut.

Gadishulli Korean është versioni mikrokozmetik i botës. Nëse do të

derdhej gjak në Gadishullin Korean, do të kishte gjakderdhje në botë. Nëse do të ndodhte pajtimi në këtë gadishull, do të kishte pajtim në botë. Nëse gadishulli do të bashkohej, kjo do të sillte bashkimin e botës. Megjithatë, duke filluar nga fundi i viteve '80, Koreja e Veriut kishte punuar shumë për t'u bërë një vend me armë bërthamore. Vendet e Perëndimit po thoshin se do të ndërmerrnin një sulm kundër Koresë së Veriut, nëse do të ishte e nevojshme. Nëse situata do të vazhdonte deri në ekstrem, nuk mund të thuhet me fjalë se çfarë lëvizjeje të dëshpëruar mund të tentonte Koreja e Veriut. E dija që, në njëfarë mënyre, më duhej të hapja një linjë komunikimi me Korenë e Veriut.

Nuk ishte një detyrë e lehtë. Bo Hi Pak komunikoi me zv/kryeministrin e Koresë së Veriut, Kim Dal Hjun, por përgjigjja e saj ishte prerazi negative.

“Populli i Koresë së Veriut e njeh Presidentin Mun si kryetarin e lëvizjes ndërkombëtare për fitoren kundër komunizmit,- tha zv/kryeministri.- Pse duhet ta mirëpresim udhëheqësin e një grupi konservator antikomunist?” Vizita e kryetarit Mun në Korenë e Veriut nuk mund të lejohet kurrsesi”.

Bo Hi Pak nuk u dorëzua. “Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Nikson, ishte një antikomunist i paepur,- i kujtoi ai zyrtarit të Koresë së Veriut. - Por ai vizitoi Kinën, takoi Maotsedunin dhe lidhi marrëdhënie diplomatike midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Ishte Kina që përfitoi nga kjo. Deri atëherë, Kina ishte e damkosur si vend agresor, por tani po zhvillohet si vend qendror në arenën botërore. Që Koreja e Veriut të ketë besueshmëri ndërkombëtare, duhet të lidhë miqësi me një antikomunist mbarëbotëror, siç është kryetari Mun”.

Përfundimisht, Kim Il Sung më ftoi mua dhe gruan time, më 30 nëntor 1991. Në atë kohë ishim në Havai, kështu që fluturuam menjëherë

në Pekin. Ndërsa po pritnim në sallën VIP të aeroportit ndërkombëtar “Capital” të Pekinit, gjë që na e kishte ofruar vetë qeveria e Kinës, një përfaqësues i qeverisë së Koresë së Veriut erdhi e na dorëzoi ftesën zyrtare. Vula zyrtare e qeverisë së Penianit ishte qartësisht e dukshme mbi dokument”.

“Republika Demokratike Popullore e Koresë i bën një ftesë Z. Mun San Mjang, Kryetarit të Federatës për Paqe Botërore, gruas dhe shoqëruesve të tij, të hyjnë në Republikë. Siguria e tyre është e garantuar gjatë periudhës së qëndrimit në Veri”.

Ishte firmosur “Kim Dal Hjun, zv/kryeministër, kabineti i Republikës Demokratike Popullore të Koresë, më 30 nëntor 1991”.

Grupi ynë mori një fluturim special të linjës Air Korjo 215, që e kishte porositur për ne presidenti Kim. Një fluturim special nga presidenti Kim nuk ishte porositur kurrë, për asnjë udhëheqës shteti, prandaj, ky ishte një trajtim special, i jashtëzakonshëm.

Avioni fluturoi mbi Detin e Verdhë, deri në Sin-ui-xhu, mbi vendlindjen time Xhong-xhu dhe vazhdoi drejt Penianit. Më informuan se ishte caktuar një trajektore speciale që të më lejonte të shikoja vendlindjen. Zemra filloi të më rrihte kur shikoja poshtë vendlindjen time të ngjyrosur në të kuqe nga drita e diellit, që ishte në perëndim, dhe kjo më bëri të mpihem i tëri. Pyesja veten: “A mund të jetë kjo me të vërtetë vendlindja ime?”. Unë desha të hidhesha menjëherë dhe të filloja të vrapoja nëpër kodra e lugina.

Në aeroportin ndërkombëtar “Sunan” të Penianit, anëtarët e familjes, të cilët kisha dyzet e tetë vjet që s’i kisha parë, ishin aty për të më përshëndetur. Motrat e mia më të vogla, të cilat kishin qenë të bukura si lule, ishin bërë gjyshe dhe po hynin në moshën madhore. Më kapën duart, rruhdën vetullat dhe filluan të qajnë me të madhe. Motra më e

madhe, mbi shtatëdhjetë vjeç, më mbërthente nga shpatullat dhe qante. Sidoqoftë, unë nuk qava.

“Ju lutem,- u thashë,- mos bëni kështu. Është e rëndësishme për mua të takoj familjen, por kam ardhur të bëj punën e Zotit. Ju lutem, mos bëni kështu. Mbajeni veten”.

Brenda zemrës po derdhja lot si një ujëvarë. Po takoja motrat e mia për herë të parë, pas më shumë se dyzet vjetësh, por nuk mund t'i përqafoja dhe të qaja me to. E mbajta nën kontroll zemrën dhe u drejtova për nga vendi ku do të qëndronim.

Mëngjesin e ditës tjetër, siç e kam pasur zakon gjatë gjithë jetës, u ngrita herët dhe fillova të lutem. Nëse do të kishte pasur ndonjë aparat përgjimi në dhomën e miqve, lutja me lot për bashkimin e Gadishullit Korean do të ishte regjistruar e plotë në përjetësi. Atë ditë ne shëtitem nëpër qytetin e Penianit. Ai ishte i fortifikuar mirë me sloganet e kuqe të ideologjisë xhuçe.

Ditën e tretë hipëm në një avion për të vizituar malin Kumgang. Megjithëse ishte dimër, ujëvara e Kurjong nuk kishte ngrirë dhe gufonte një sasi madhe uji. Në ditën e gjashtë, pasi vizituam të gjitha pjesët e malit Kumgang, hipëm në një helikopter dhe shkuam në vendlindjen time. Në ëndërr kisha ndërë një mall aq të madh për shtëpinë e fëmijërisë, sa doja të shkoja drejt saj me një kërcim të vetëm. Dhe ja ku e kisha, tek më shfaqej përballë. Nuk u besoja dot syve. Ishte ëndërr apo realitet? Për njëfarë kohe, që m'u duk më e gjata, munda vetëm të qëndroja aty, si statujë përballë shtëpisë sime. Pas disa minutash u futa brenda. Më parë ishte në formë katror bosh, me anën kryesore, anën e miqve, magazinën dhe plevicën; ndërtuar me në qendër oborrin. Tani kishte mbetur vetëm pjesa kryesore. Hyra në dhomën kryesore, aty ku kisha lindur, dhe u ula në dysheme këmbëkryq. Kujtimet e fëmijërisë

m'u kthyen aq të qarta, sikur të kishin ndodhur dje. Hapa derën e vogël, që të çonte nga dhoma kryesore në kuzhinë dhe hodha sytë përjashta, në oborrin e pasmë. Pema e gështenjës ku isha mësuar të hipja ishte prerë dhe nuk ishte më. M'u duk sikur dëgjova nënën që më thërriste me ëmbëlsi: "A është i uritur picirruku im syvogël?". Pëlhura e pambuktë e fustanit të saj tradicional më kaloi vetëtimthi para syve.

Shkova tek varret e prindërve dhe vura një buqetë me lule. Për herë të fundit, nënën time e kisha parë kur erdhi për të më parë në burgun Hëngnam dhe qau me të madhe. Varri i saj ishte mbuluar nga një shtresë e hollë bore, rënë një natë më parë. E fshiva me pëllëmbën e dorës dhe përkëdhela butë barin që ishte rritur mbi të. Ashpërsia e barit më kujtoi ashpërsinë e lëkurës së kurrizit të duarve të nënës sime.

Takimi me Presidentin Kim Il Sung



Nuk kisha shkuar në Kore se doja të shihja vendlindjen, apo sepse doja të shëtisja në malin Kungang. Doja të takoja presidentin Kim Il Sung dhe të zhvilloja një diskutim serioz për të ardhmen e atdheut tonë. Megjithatë, pas gjashtë ditëve të vizitës, nuk kishte asnjë fjalë nëse do të mund të rregullohej ndonjë takim me presidentin Kim. Kur u kthyem në aeroportin Sunan të Penianit me helikopter, pasi kishim vizituar vendlindjen time, morëm vesh se zv/kryeministri Kim Dal Hjun kishte ardhur papritur për të më takuar.

“Udhëheqësi i madh Kim Il Sung do t’ju presë nesër, - më tha. - Vendi i takimit do të jetë rezidenca presidenciale Mexhon në Hëngnam. Kësh-tu që do t’ju duhet të bëni një fluturim special menjëherë dhe të shkoni në Hëngnam”.

Mendova me vete: “Thonë se ai ka shumë rezidenca presidenciale. Pse duhet të zgjedhë midis gjithë atyre Hëngnamin?”

Rrugës vura re një tabelë të madhe, që tregonte fabrikën e plehut të nitrogenit në Hëngnam, ku më kishin detyruar të punoja. M’u kujtua koha e burgut dhe më përshkoi një ndjenjë e çuditshme. E kalova natën në një shtëpi pritjeje qeveritare dhe ditën tjetër shkova për të takuar presidentin.

Ndërsa i afrohesha rezidencës zyrtare, gjeta presidentin Kim që po

më priste në hyrje. U përqaftuam në të njëjtën kohë. Unë isha një antikomunist, kurse ai udhëheqësi i një partie komuniste, por ideologjia dhe filozofia nuk ishin të rëndësishme në kontekstin e takimit tonë. Ishim tamam si vëllezër, që po takoheshin për herë të parë, pas një ndarjeje të gjatë. Kjo ishte fuqia e faktit, se i përkisnim të njëjtit popull dhe kishim të njëjtin gjak.

Që në fillim fare i thashë: “Zoti president! Për shkak të zemërgjerësisë suaj unë munda të takoj familjen time. Mirëpo, janë dhjetë milionë koreanë, anëtarët e familjeve të të cilëve janë ndarë ndërmjet Veriut dhe Jugut. Ata nuk kanë mundësi të dinë nëse të afërmit e tyre në anën tjetër janë gjallë apo vdekur. Do të doja t’ju kërkoja t’u jepnit mundësinë të takohen me njëri-tjetrin”.

Fola dhe pak, duke i treguar rreth vizitës në vendlindje, dhe i bëra thirrje dashurisë së tij për popullin korean. Ai dhe unë flisnim të njëjtin dialekt, prandaj u ndiemë rehat me njëri-tjetrin.

Presidenti Kim u përgjigj: “Ashtu mendoj edhe unë. Që nga viti tjetër, le të fillojmë një lëvizje që lejon bashkëpatriotët, e ndarë në Veri dhe në Jug, të takohen me njëri-tjetrin”. Pranimi i propozimit nga ana e tij ishte po aq i natyrshëm sa shkrirja e borës në pranverë.

Pasi fola rreth vizitës sime në Xhong-xhu, nisa të shpreh pikëpamjen time në lidhje me armët bërthamore. I propozova, me respekt, që Koreja e Veriut duhet të binte dakord me një deklaratë për çarmatimin bërthamor të Gadishullit Korean dhe se duhet të firmoste një marrëveshje sigurie me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike.

Presidenti Kim u përgjigj me çiltërsi: “Mendo për një çast. Kë do të vras duke bërë armë bërthamore? Do të vras popullin tim? A të dukem unë një person i atillë? Unë e pranoj që energjia bërthamore duhet përdorur vetëm për qëllime paqësore. E dëgjova me vëmendje atë që kishe

për të më thënë dhe kam shpresë se gjithçka do të jetë në rregull”.

Në atë kohë, marrëdhëniet Veri-Jug ishin në një çast të vështirë, për shkak të çështjes së inspektimeve bërthamore në Korenë e Veriut, prandaj e bëra propozimin me një farë ngurrimi. Megjithatë, të gjithë të pranishmit u habitën që presidenti Kim u përgjigj me një ton kaq të këndshëm. Pas kësaj, e vazhduam bisedën në dhomën e ngrënies, ku drekuam më herët se zakonisht.

“A i njeh *makaronat e ngrira të patates*? Është një gjellë që e kam ngrënë, shumë shpesh, kur isha partizan në malin Bekdu. Të lutem, provoj!”

“Epo, sigurisht që e njoh këtë gjellë,- i thashë, duke iu përgjigjur me kënaqësi, - Në vendlindje kjo gjellë na pëlqente”.

“Epo, jam i sigurt që në vendlindjen tuaj e keni ngrënë si gjellë të mirë,- vazhdoi ai,- por ne e hanim për të mbijetuar. Policia japoneze na kërkonte deri në majë të malit Bekdu. Nuk kishim mundësi të uleshim e të hanim një vakt për të qenë. Çfarë ka tjetër për të ngrënë në majë të malit Bekdu, përveç patateve?”

“Fillonim të zienim patate, por, nëse na ndiqte policia japoneze, i groposnim patatet dhe ia mbathnim. Ishte aq ftohtë sa, kur ktheheshim, patatet kishin ngrirë. E vetmja gjë, që mund të bënim, ishte të gërmonim për të gjetur patatet, t’i shkrinim dhe t’i bënim pluhur dhe, pastaj, të bënim me to makarona.”

“Zoti President,- i thashë,- ju jeni një ekspert i makaronave me miell patatesh të ngrira”.

“Ashtu është. Janë shumë të shijshme, po t’i përziësh me fasule, dhe janë akoma më të shijshme kur i ha me supë susami. Është gjellë e lehtë për t’u tretur dhe, ngaqë patatet kanë vetinë të ngjiten me njëra-tjetrën, ajo të ngop shumë.”

Po ashtu, Kryetar Mun,- vazhdoi ai,- ato kanë shije vërtet të mirë, nëse i bëni siç i bëjnë ata të provincës Ham Giung. Merrni disa gjethe mustarde kimçi dhe i hidhni mbi makarona. Duhet ta provoni”.

Bëra siç më sugjeroi ai dhe i hëngra makaronat me patate të ngrira, me disa gjethe kimçi mustarde mbi to. Aroma e shijshme e makaronave shkante me kimçin djegës, dhe më bëri ta ndjeja stomakun të lehtë.

“Ka shumë lloje gjellësh të mira në botë,- tha presidenti Kim, por nuk më intereson asnjëra prej tyre. Nuk ka asgjë më të mirë sesa ëmbëlsirat me patate, misri dhe patatet e ëmbla, që haja dikur në vendlindjen time”.

“Ti dhe unë ngajmë edhe në ushqimet që na pëlqejnë,- i thashë.- Është mirë kur njerëzit, që vijnë nga i njëjti vend, kanë mundësi të takohen kështu”.

“Si t’u duk kur vizitove vendlindjen tënde?”, më pyeti.

“U ndjeva shumë i emocionuar,- i thashë. Shtëpia ku kisha jetuar ishte ende atje. U ula në dhomën kryesore duke sjellë ndër mend të kaluarën. Pothuajse, prisja të dëgjoja zërin e së ndjerës nënë të më thërriste. Ishte një ndjenjë shumë emocionuese”.

“E kuptoj,- tha ai.- Kjo tregon se vendi ynë duhet të bashkohet menjëherë. Kam dëgjuar se i vogël ke qenë shumë i prapë. A pate shansin të vrapoje ku të doje këtë radhë?”.

Gjithë sa ishin në tavolinë qeshën me komentin e presidentit.

“Doja të ngjitesha në një pemë dhe të shkoja për peshkim, por mora vesh që ju po më prisnit, kështu që erdha me të shpejtë këtu. Shpresoj se do të më ftosh të vij përsëri ndonjë herë tjetër”.

“Ah po, sigurisht. Sigurisht që do të ftoj. Kryetari Mun, a të pëlqen gjuetia? Mua më pëlqen shumë të dal për gjah. Mendoj se, nëse shkon për të gjuajtur arinj në malin Baekdu, do të kënaqesh shumë. Arinjtë kanë trupa të mëdhenj dhe duken të pakoordinuar, por në fakt janë

shumë të zhdërvjellët.

“U gjenda njëherë ballë përballë me një ari”,- vazhdoi ai. – Ariu më pa dhe nuk lëvizi asnjë muskul. Nëse do të kisha filluar të vrapoja, ti e di se çfarë do të më kishte ndodhur, apo jo? Kështu që, çfarë të bëja? Ia ngula sytë dhe qëndrova përballë tij. Kaloi një orë, pastaj dy, pastaj tri orë. Por ariu vetëm vazhdonte të më shikonte me ngulm. Ti e ke parasysh të ftohtin e malit Baekdu!? Kisha frikë se do të vdisja i ngrirë, para se të më hante ariu”.

“Pastaj, çfarë ndodhi?” - e pyeta unë.

“Si thoni ju, kryetar Mun, a shikoni ariun të ulur këtu, apo më shikoni mua?”.

Unë qesha me zë të lartë dhe presidenti Kim vazhdoi menjëherë me një sugjerim.

“Kryetar Mun,- tha ai,- kur të vish herën tjetër, le të shkojmë për gjah në malin Baekdu.”

Iu përgjigja menjëherë me ftesën time.

“Zoti President, juve ju pëlqen peshkimi, apo jo? Në ishullin Kodiak, në Alaskë, ju mund të kapni shojëza, që janë të mëdha sa një ari. Shkojmë peshkojmë nga ato ndonjëherë”.

“Shojëz e madhe sa një ari? Atëherë duhet të shkoj patjetër”.

Të dy patëm mundësinë të bisedonim lirshëm rreth pasioneve të për-bashkëta, gjuetisë dhe peshkimit. Në një çast, na u duk sikur kishim aq shumë gjëra për t'i thënë njëri-tjetrit, sa filluam të flisnim tamam si shokë të vjetër, që ishin takuar pas një ndarjeje të gjatë. Të qeshurat tona kumbonin në dhomën e ngrënies.

Fola edhe për malin Kumgang.

“Shkova në malin Kumgang dhe është me të vërtetë një mal i bukur,- i thashë. - Ka nevojë të zhvillohet si një pikë turistike për popullin tonë.”

“Mali Kungang do të jetë një pasuri e atdheut tonë të bashkuar,- tha presidenti Kim.- Prandaj e kam lënë vetëm në duart e disa njerëzve të veçantë. Nëse zhvillohet në mënyrë të gabuar, mund të shkatërrohet. Ju keni një sy ndërkombëtar, prandaj mund t’ia besoja dikujt si puna juaj për ta marrë përsipër dhe për ta zhvilluar atë për ne”.

Presidenti Kim shkoi deri aty, sa na kërkoi ta zhvillonim malin Kungang së bashku.

“Zoti President,- i thashë, ju jeni më i madh se unë, prandaj jeni tamam si vëllai im i madh”.

Ai u përgjigj: “Kryetari Mun, që tani e tutje le ta konsiderojmë njëritjetrit si vëlla i madh dhe vëlla i vogël”,- dhe më shtrëngoi fort nga dora.

Presidenti Kim dhe unë u kapëm përdore, ndërsa ecnim nëpër korridor dhe bënim fotografi përkujtimore. Pastaj u largova nga rezidenca.

Pasi isha larguar, më thanë se presidenti Kim i kishte thënë të birit, Kim Xhong Il: “Kryetari Mun është një njeri i madh. Kam takuar shumë njerëz në jetën time, por askush nuk ka qenë si ai. Ai ka një mënyrë të gjerë të menduari dhe të mbulon me dashuri. U ndjeva shumë i afërt me të. Kjo gjë më bëri të ndihem mirë. Ndihesha rehat kur isha me të dhe doja që ai të rrinte për një kohë të gjatë me mua. Dua ta takoj përsëri. Pasi të vdes, nëse ka gjëra për të diskutuar lidhur me marrëdhëniet Veri-Jug, duhet të kërkosh gjithmonë këshilla nga kryetari Mun”.

Pra, ishte e qartë që kishim kaluar mirë.

Pak pasi kisha mbaruar qëndrimin njëjavor dhe isha larguar nga Peniani, kryeministri Hiung Muk Jon udhëhoqi një delegacion për në Seul. Kryeministri Jon firmosi një marrëveshje për çarmatosjen bërthamore të Gadishullit Korean. Më 30 janar të vitit që pasoi, Koreja e Veriut firmosi një marrëveshje sigurie me Agjencinë Ndërkombëtare në Energjisë Atomike, duke përmbushur kështu premtimet që më kishte bërë

presidenti Kim. Këto ishin rezultatet që arrita duke shkuar në Penian, duke vënë në rrezik jetën time.

Toka edhe mund të ndahet, por njerëzit e saj jo



Gadishulli Korean është një nga vendet e fundit që kanë mbetur të ndara në tokë. Ne kemi përgjegjësinë ta bashkojmë gadishullin. Nuk mund t'i lemë trashëgim pasardhësve tanë një atdhe të ndarë. Është e papranueshme që një popull të ndahet dhe që njerëzit paqedashës të tij mos jenë në gjendje të takohen me prindërit apo me vëllezërit dhe motrat e tyre. Vija që ndan Korenë e Veriut nga ajo e Jugut u bë nga qenie njerëzore. Toka mund të ndahet ashtu, por jo njerëzit. Fakti që nuk e harrojmë njëri-tjetrin dhe që vazhdojmë të digjemi për njëri-tjetrin, edhe pas gjashtëdhjetë vitesh ndarje, tregon se ne jemi i njëjti popull.

Populli korean njihet tradicionalisht si “populli i veshur me të bardha”, për shkak të ngjyrës së veshjeve tona tradicionale. E bardha është simboli i paqes, dhe populli ynë është popull i paqes. Gjatë kohës së pushtimit japonez, koreanët, kinezët dhe japonezët jetonin në Mançuri dhe Siberi, herë duke ndihmuar njëri-tjetrin, herë duke u vrarë me njëri-tjetrin. Gjatë asaj kohe, koreanët kurrë nuk mbanin shpata ose thika, siç bënin japonezët dhe kinezët. Në vend të kësaj, mbanim gurë stralli. Ndezja e zjarrit në tokën e ngrirë të Mançurisë dhe Siberisë, ishte

një mënyrë për të mbrojtur jetën.

Ja çfarë populli jemi ne. Kemi respekt për Qiellin, u përmbahemi parimeve morale, dhe e duam paqen. Populli ynë ka derdhur shumë gjak gjatë pushtimit japonez dhe gjatë Luftës Koreane. Megjithatë, kjo nuk solli bashkimin e vendit apo vendosjen e sovranitetit të paqes. Vendi ynë u nda në mes, në dy gjysma, ku njëra pjesë u shndërrua në botën e errët të komunizmit.

Ne na duhet bashkimi për të rifituar sovranitetin e popullit tonë. Duhet t'i japim fund ndarjes midis Veriut dhe Jugut, në mënyrë që të kemi paqe. Vetëm pasi të kemi arritur bashkimin paqësor dhe të kemi rifituar sovranitetin tonë, ne mund të sjellim paqe në botë.

Populli korean u krijua për të sjellë paqen në botë. Gjithçka ka një emër, dhe çdo emër ka një domethënie. Rrobat tona të bardha tradicionale dallohen lehtë si natën, ashtu edhe ditën. E bardha është mirë të përdoret si shenjë gjatë natës, sepse dallohet lehtë në errësirë. Po ashtu populli ynë është i paracaktuar të transmetojë mesazhet e paqes në mbarë botën, si ditën, ashtu edhe natën.

Veriu dhe Jugu janë të ndarë nga një vijë armëpushimi, por problemi nuk qëndron këtu. Sapo të heqim atë vijë, do të gjejmë një barrierë, edhe më të lartë, midis nesh dhe midis Rusisë e Kinës. Në mënyrë që populli ynë t'i gëzohet paqes së vërtetë, do të na duhet të kapërcejmë edhe ato vija armëpushimi. Do të jetë e vështirë, por jo e pamundur. Gjëja më e rëndësishme është qëndrimi ynë.

Besoj se, kur dikush djersin, duhet ta nxjerrë edhe pikën e fundit të djersës që ndodhet tek ai. Kështu nuk do të ketë keqardhje, dhe gjithçka do të jetë e pastër dhe e rregullt. E njëjta gjë është kur tentojmë të bëjmë diçka të vështirë. Vështirësia do të marrë fund vetëm kur ju të keni korrur fitore në çdo fazë, dhe gjithçka të jetë qartësuar. Gjithçka me

të cilën merreni duhet të vihet në një rregull të plotë që, pastaj, mund të japë fryte. Ne nuk e rifitojmë dot sovranitetin e plotë të popullit tonë, pa përjetuar vështirësi kaq të përvajshme.

Sot shumë njerëz flasin për bashkimin paqësor. Sidoqoftë unë kam folur rreth tij në një kohë kur njerëzit nuk kishin guximin të përdornin as frazën “bashkim paqësor”, nga frika se mos akuzoheshin për dhunimin e ligjit kundër komunizmit dhe ligjit të sigurisë kombëtare. Sot, kur më pyesin se çfarë duhet bërë për të arritur bashkimin, u them atë që kam thënë gjithmonë për këtë çështje: “Nëse koreano-jugorët e duan Korenë e Veriut më shumë se Jugun dhe, nëse koreano-veriorët e duan Korenë e Jugut më shumë sesa Veriun, mund ta bashkonim gadishullin që sot.”

Unë qeshë në gjendje të rrezikoja jetën për të shkuar në Korenë e Veriut në vitin 1991, për të takuar presidentin Kim, sepse kisha themelin e një dashurie të tillë brenda meje. Atëherë bëra marrëveshje me të lidhur me takimin e familjeve të ndara, lidhur me bashkëpunimin ekonomik Veri-Jug, lidhur me malin Kumgang, lidhur me çarmatosjen bërthamore të Gadishullit Korean, dhe për të punuar për organizimin e një konference të nivelit të lartë Veri-Jug. Askush nuk e kishte menduar që: një antikomunist mund të shkonte në një vend komunist dhe mund të hapte portën e bashkimit, por unë e çudita botën.

Para takimit me presidentin Kim, mbajta një fjalim dy orësh të titulluar “Gjaku është më i trashë se uji”, në sallën e kuvendit në Mansude, vendi i mbledhjes së Kuvendit Suprem të Popullit nga legjislatura e Koresë së Veriut. I fola atë ditë udhëheqjes së Koresë së Veriut rreth mënyrës së bashkimit me dashuri të Veriut dhe Jugut. Qëndrova para udhëheqjes së Koresë së Veriut, që ishte e armatosur me filozofinë e Kim Il Sung, dhe u thashë atyre saktësisht atë që besoja.

“Veriu dhe Jugu duhet të bashkohen,- thashë unë,- por armët dhe shpatat nuk do të na bëjnë një. Bashkimi Veri-Jug nuk do të ndodhë me forcë ushtarake. Madje, edhe lufta koreane dështoi në këtë kuptim, prandaj është budallallëk të mendohet për ndonjë tentativë tjetër me forcë ushtarake. Bashkimi nuk do të ndodhë as me ideologjinë xhuçe që keni përqaftuar ju. Kush do ta bëjë atëherë? Bota nuk operon vetëm me fuqinë e qenieve njerëzore. Meqë Zoti ekziston, asgjë nuk mund të bëhet vetëm me përpjekje njerëzore. Madje, edhe në situata të vështira si luftërat, Zoti vazhdon të ndjekë planin e tij. Prandaj Veriu dhe Jugu nuk mund të bashkohen me anë të ideologjisë xhuçe, që e vë njeriun në qendër”.

“Arritja e një atdheu të bashkuar mund të realizohet vetëm me anë të zotizmit,- vazhdova unë.- Zoti po na mbron, dhe koha e bashkimit tonë po vjen. Bashkimi është i parashkruar: është detyra që duhet përbushur në epokën tonë. Nëse nuk përbushim detyrën e shenjtë të bashkimit të atdheut gjatë kohës sonë, nuk do të jemi në gjendje të ngremë kokën para paraardhësve dhe pasardhësve tanë në përjetësi”.

“Çfarë është zotizmi? Është zbatimi i dashurisë së përsosur të Zotit. As krahu i djathtë dhe as krahu i majtë nuk e bashkojnë dot Veriun dhe Jugun. Kjo do të bëhet e mundur vetëm kur të ekzistojë një ‘mendim i kreut’, që është në gjendje t’i harmonizojë këto të dyja”.

“Që të ecni në rrugën e dashurisë, ju duhet të kërkonti falje para botës për pushtimin që i bëtë Jugut. Kam marrë vesh se Koreja e Veriut ka futur njëzet mijë rezidentë spiunë në Jug. Dërgojini menjëherë urdhër të gjithë atyre, duke i udhëzuar të dorëzohen tek autoritetet e Koresë së Jugut. Nëse e bëni këtë unë do t’i edukoj, në mënyrë që t’ua korrigjoni ideologjinë dhe t’i kthej në patriotë, që do të kontribuojnë në bashkimin paqësor të Veriut me Jugun”.

Teksa flisja qëllonja tavolinën që kisha përpara. Fytyrat e z. Jun Ki Bok dhe zv/kryeministrit Kim Dal Hjun u tensionuan. Isha i vetëdijshëm për rrezikun që më kanosej duke bërë një deklaratë të tillë, por duhet të thosha atë për të cilën kisha ardhur. Unë nuk po mundohesha të tronditja të pranishmit. E dija që fjalimi im do t'i raportohej menjëherë, fjalë për fjalë, presidentit Kim dhe djalit të tij, kryetarit Kim Xhong Il, prandaj doja ta deklaroja qartë qëllimin tim.

Kur mbarova, disa nga koreano-veriorët, që ishin aty, protestuan duke kërkuar të dinin se si guxova të flisja në atë mënyrë. Pashë nga shoqëruesit e mi dhe vura re se fytyrat e tyre ishin zverdhura nga frika. Anëtarët tanë, që ishin me mua, më thanë: “Fjalimi kishte një ton shumë të ashpër dhe atmosfera në publik nuk ishte e mirë”.

Megjithatë unë nuk u lëkunda. “Pse kam ardhur këtu?,- i pyeta.- Nuk kam ardhur të shikoj tokën e Koresë së Veriut. Nëse do të largohesha nga këtu pa thënë ato që duheshin thënë, Qielli do të më ndëshkonte. Edhe sikur fjalimi i sotëm të përdoret nga ata si justifikim për të mos më lejuar të takohem me presidentin Kim dhe për të më dëbuar nga vendi, përsëri duhet ta thosha atë për të cilën kam ardhur”.

Më 8 korrik të vitit 1994, papritur, presidenti Kim vdiq. Vdekja e tij ndodhi atëherë kur marrëdhëniet Veri-Jug ishin në pikën më të ulët. Në tokën e Koresë së Jugut ishin dislokuar raketa “Patriot” dhe grabitqarët nga Shtetet e Bashkuara përkrahnin shkatërrimin e pajisjeve bërthamore në Jongbion. Dukej sikur lufta mund të shpërthente nga një çast në tjetrin. Koreja e Veriut njoftoi se nuk do të pranonte ngushëllues nga jashtë vendit, por e ndjeva se ishte e rëndësishme të dërgonim dikë. Doja të përmbushja detyrimin tim, meqë kisha lidhur një marrëdhënie vël-lazërore me presidentin Kim.

Thirra Bo Hi Pak. “Shko menjëherë në Korenë e Veriut, si përfaqë-

suesi im, për të ngushëlluar për vdekjen e presidentit Kim”,- i thashë. “Askush nuk mund të hyjë në Korenë e Veriut tani”,- tha ai.

“E di që është e vështirë, por ti duhet të gjesh një mënyrë për të shkuar atje. Nuk dua t’ia di edhe sikur të duhet të kalosh me not lumin Jalu. Hyr atje dhe përcillu ngushëllimet e mia”.

Në fillim Bo Hi Pak shkoi në Pekin dhe vuri jetën e tij në rrezik për të komunikuar me Korenë e Veriut. Atëherë kryetari Kim Xhong Il dha urdhër: “Do të bëhet një përjashtim vetëm për personin, që vjen për ngushëllime si përfaqësues i kryetarit Mun. Shoqërojeni atë deri në Penian”.

Pasi u shprehën ngushëllimet, kryetari Kim Xhong Il u takua me Bo Hi Pak dhe e përshëndeti përzemërsisht, duke i thënë: “Babai im thoshte gjithmonë se kryetari Mun po punon shumë për bashkimin e atdheut tonë. Jam i kënaqur që erdhët”.

Në vitin 1994, Gadishulli Korean ishte në një krizë të tillë, sa që mund të shpërthente në çdo kohë. Në atë moment, qemë në gjendje ta zgjidhnim krizën bërthamore në Gadishullin Korean, falë marrëdhënies që kisha krijuar me presidentin Kim Il Sung. Dërgimi i një përfaqësuesi për të shprehur ngushëllimet nuk ishte thjesht një çështje zie.

E përshkrova takimin tim me presidentin Kim me detaje të shumta, për të ilustruar theksin tim mbi rëndësinë që ka besimi dhe besnikëria ndërmjet dy njerëzve. E takova atë për hir të bashkimit paqësor të atdheut tonë. Qeshë në gjendje të transmetoj tek ai shqetësimet e mia lidhur me fatin e popullit tonë, me besim dhe besnikëri. Për rrjedhojë, pas vdekjes së tij, i biri, kryetari Kim Xhong Il, pranoi përfaqësuesin tonë në zi. Nuk ka mur që nuk mund të kapërcehet dhe nuk ka ëndërr që nuk mund të realizohet, kur shpërndajmë dashuri me zemër të sinqertë.

Kur shkova në Korenë e Veriut, e mendova si atdheun tim dhe si

shtëpinë e vëllait tim. Nuk shkova atje me dëshirën për të marrë diçka prej tyre. Unë shkova me qëllim që të ndaja me ta dashurinë e zemrës sime. Fuqia e dashurisë preku jo vetëm Kim Il Sung, por edhe të birin, kryetarin Kim Xhong Il. Që atëherë e deri më sot, kemi ruajtur një marrëdhënie të veçantë me Korenë e Veriut. Sa herë marrëdhëniet Veri-Jug janë vështirësuar, ne kemi luajtur një rol të rëndësishëm në rihapjen e rrugës. Gjithçka bazohet në faktin që unë takova presidentin Kim Il Sung, i përcolla atij zemrën time të sinqertë dhe ndërtova një marrëdhënie mirëbesimi me të. Ja pra, sa i rëndësishëm është mirëbesimi.

Pas takimit me presidentin Kim ne, tashmë, kemi në Korenë e Veriut, uzinën e motorëve Pionghua, hotelin “Potongang” dhe Qendrën e Paqes Botërore. Nëpër Penian mund të shihen tabelat e reklamave të motorëve “Pionghua”. Kur presidenti i Koresë së Jugut vizitoi Korenë e Veriut, zyrtarët koreano-veriorë e çuan në uzinën e motorëve “Pionghua”. Drejtuesit e bizneseve koreano-jugore, që shoqëronin presidentin, qëndruan në hotelin “Potongang”. Anëtarët jo koreano-veriorë të kishës sonë, që punojnë në Korenë e Veriut, mblidhen në Qendrën e Paqes Botërore, çdo të diel, për shërbesën e adhurimit.

Të gjitha këto projekte janë përpjekje për hir të shkëmbimeve dhe bashkimit paqësor të Veriut dhe Jugut. Ato nuk po bëhen për qëllime përfitimi. Janë përpjekje që kontribuojnë në bashkimin e Veriut dhe Jugut, si shprehje e dashurisë për popullin korean.

As me pushkë dhe as me shpata, por me dashuri të vërtetë



Nuk është vetëm vija e armëpushimit që ndan popullin tonë. Rajonet e Jounghnam dhe Honam janë gjithashtu të ndara nga një vijë e padukshme. Gjithashtu edhe koreanët, që jetojnë në Japoni, janë të ndarë midis Bashkimi i Rezidentëve në Japoni, ose Mindani, që është pro Koresë së Jugut dhe Shoqata e Përgjithshme e Rezidentëve koreanë në Japoni, ose Çongrjon, që janë pro Koresë së Veriut. Konflikti ndërmjet dy organizatave në Japoni bazohet në vendlindjet e anëtarëve përkatës. Brezi i dytë dhe brezi i tretë i rezidentëve koreanë në Japoni, të cilët nuk kanë qenë kurrë në vendlindjen e prindërve, ende jetojnë në konflikt me njëri-tjetrin, meqë jetojnë brenda kufijve të vendosur nga prindërit e tyre. Anëtarët e këtyre dy organizatave përdorin gjuhë paksa të ndryshme, i dërgojnë fëmijët në shkolla të ndryshme dhe nuk martohen ndërmjet tyre.

Në vitin 2005, bëra realitet planin tim, që e kisha menduar gjatë, për të bashkuar koreanët në Japoni, si edhe ata në rajonet Jounghnam dhe Honam. Ftova në Seul një mijë anëtarë nga Mindan dhe një mijë anëtarë nga Çongrjon, dhe i bashkova në ceremoni binjakëzimi me një mijë vetë nga rajoni Jounghnam si dhe me një mijë vetë nga rajoni Honam. Është

pothuajse e pamundur që: ata nga Çongrjon të ulen me ata nga Mindan, në Japoni, dhe të flasin rreth bashkimit paqësor të Veriut dhe Jugut. T'i mblidhje këta njerëz në një vend ishte një detyrë e vështirë, por ishte thellësisht prekëse për mua, kur i shikoja të ulur pranë duke përqa-fuar njëri-tjetrin. Një zyrtar nga Çongrjon, që merrte pjesë në takim, e vizitonte për herë të parë Seul. Ai foli duke qarë, teksa komentonte se ishte thellësisht i penduar për gjithë vitet që kishte shpenzuar duke luftuar një betejë që nuk ishte e tija, veçanërisht sepse ai nuk e kishte të sigurt se nga cila pjesë e gadishullit vinte babai i tij. Ai tha se ndihej i turpëruar pa masë, që kishte jetuar jetën me një vijë ndarëse të pakup-timtë, që kishte zënë vend në zemrën e tij.

Për të kuptuar plotësisht ndarjen e Gadishullit Korean dhe konflik-tin ndërmjet dy pjesëve, duhet të jemi në gjendje të shohim në tërësi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Çdo incident e ka një shkak rrënjësor. Ndarja e Gadishullit Korean u krijua nga historia e betejës ndërmjet së mirës dhe së keqes. Kur shpërtheu Lufta Koreane, Bashkimi Sovjetik, Kina dhe vendet e tjera komuniste i erdhën në ndihmë Koresë së Veriut. Në të njëjtën mënyrë, gjashtëmbëdhjetë vende, të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara, dërguan forca të armatosura në ndihmë të Ko-resë së Jugut. Gjithashtu, pesë kombe dërguan skuadra mjekësore, dhe njëzet kombe siguruan furnizime luftar. Cila luftë në histori ka përfshirë kaq shumë vende në luftim? Arsyeja, pse e gjithë bota u përfshi në luftën e një vendi të vogël si Koreja, ishte se kjo qe një luftë që përfaqësonte përplasjen mes forcave të komunizmit dhe forcave për liri. Mund të thuhet që Koreja përfaqësonte botën, dhe se e mira dhe e keqja luftuan ashpër në tokën e saj.

Gjenerali i dalë në pension dhe ish-sekretari i Shtetit të ShBA, Alexander Heig, bëri një deklaratë të papritur në fjalimin e tij përurues në

dhjetëvjetorin e gazetës “Washington Times”, në vitin 1992.

“Unë jam veteran i luftës koreane”,- tha ai.- Si komandant, isha përgjegjës për sulmin mbi Hëngnam, dhe organizuam sulmin më të fortë të mundshëm. Jam i prekur thellë kur dëgjoj se reverend Mun, që mbahej rob nga komunistët, u çlirua pikërisht nga sulmi i asaj dite. Duket sikur isha dërguar atje për të çliruar reverend Munin. Tani, reverend Mun është këtu për të shpëtuar Amerikën. “Washington Times” është një gazetë që do të shpëtojë popullin amerikan, duke i siguruar atij një pikëpamje të ekuilibruar të historisë, që nuk është as e djathtë dhe as e majtë, dhe që na tregon mënyrën për të ecur përpara. Siç e shohim, nuk ka rastësi në histori”.

Disa vite më parë, në Kore kishte njerëz që argumentonin se statuja e famshme e gjeneralit Dagllas MekArtur, në një park të Inçonit, duhet të hiqej. Nëse forcat e Kombeve të Bashkuara nuk do të ishin bashkuar me përpjekjet e luftës, vendi nuk do të ishte ndarë në Veri dhe Jug, siç është sot, vazhdonte argumentimi. U trondita, kur e dëgjova këtë, dhe e kundërshtova me forcë atë. Një argument i tillë mund të sillet vetëm nëse gjërat shihen me syrin e Partisë Komuniste të Koresë së Veriut.

Sakrificat të mëdha janë bërë në nivel global e, megjithatë, gadishulli mbetet i ndarë. Ne nuk e dimë datën e saktë se kur do të ndodhë bashkimi, por është e qartë që po bëjmë hapa të mëdha në atë drejtim. Ka shumë pengesa që duhen kapërcyer gjatë rrugës së bashkimit. Ndërsa vihemi para çdo pengese, na duhet të punojmë për ta shkatërruar atë dhe më pas të ecim përpara. Megjithëse mund të shkojë gjatë dhe mund të jetë e vështirë, bashkimi do të vijë patjetër, nëse punojmë me të njëjtin stërmundim, sikur të ishim duke notuar për të kaluar lumin Jalu.

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Rumania ishte ajo që i rezistoi ndryshimit më gjatë ndër vendet komuniste të Evropës Qendrore

dhe Lindore. Atëherë, në fundin e vitit 1989, Rumania përjetoi një kryengritje të përgjakshme nga populli i saj. Sapo regjimi u shemb, Nikolai Çaushesku, që e kishte udhëhequr vendin për njëzetekatër vjet, u ekzekutua së bashku me gruan. Ai ishte një diktator i egër, që kishte masakruar pa mëshirë të gjithë ata që kundërshtonin politikën e tij. Në çdo komb, arsyeja pse një diktator do të tentojë të shtrëngojë litarët, është se ai ka frikë për jetën e tij, në çastin kur do të bjerë nga pozita. Mendoj se, nëse një diktator do të ishte i sigurt se jeta e tij nuk do të vihej në rrezik, atëherë nuk do të ecte rrëmbimthi në një rrugë pa krye, siç bëri Çaushesku.

Edhe vendi ynë, gjithashtu, do të bashkohet shpejt, në një mënyrë ose një tjetër. Kështu që politikanët dhe ekonomistët duhet të bëjnë përgatitjet e nevojshme në fushat përkatëse të ekspertizës. Si një besimtar, do të punoj shumë, që të përgatitem për të përshëndetur Korenë e Bashkuar, në të cilën mund të përqafojmë popullin korean-verior me dashuri dhe të jetojmë në paqe të përbashkët.

Kam studiuar bashkimin e Gjermanisë për një kohë të gjatë. Kam dëgjuar përjetimet e atyre që ishin përfshirë atje, në lidhje me faktin se si mundi të vijë ai bashkim: pa asnjë plumb të shtënë dhe pa asnjë pikë gjaku të derdhur. Duke studiuar këtë mënyrë, shpresa ime ka qenë të gjej një rrugë të përshtatshme për Korenë. Kam mësuar se arsyeja kryesore pse Gjermania mundi të bashkohet paqësisht ishte, sepse udhëheqësve të Gjermanisë Lindore iu bë e qartë se jeta e tyre nuk do të ishte në rrezik pas bashkimit. Nëse udhëheqësit e Gjermanisë Lindore nuk do të kishin besuar se do të ndodhte ashtu, ata nuk do të kishin lejuar që bashkimi të ndodhte aq lehtë.

Arrita të kuptoj se duhet të bëjmë të njëjtën gjë me drejtuesit e Koresë së Veriut. Pak kohë më parë, në Japoni është publikuar një roman

me temë nga Koreja e Veriut. Në këtë libër artistik, sunduesit e Koresë së Veriut vazhdimisht shikonin një video të ekzekutimit të Çausheskut dhe bërtisnin me të madhe: “Ja çfarë na pret, nëse humbim pushtetin. Në asnjë mënyrë nuk mund të lejojmë të na ikë nga dora pushteti.”

Sigurisht që ky është vetëm një roman i botuar në Japoni. Sidoqoftë, ne duhet t'i kushtojmë vëmendje këtij problemi real dhe duhet të gjejmë një zgjidhje për udhëheqësit koreano-veriorë për të përshpejtuar unifikimin e Koresë. Ndërtimi i paqes në Gadishullin Korean nuk është aq i vështirë sa ç'mendohet. Kur Koreja e Jugut të jetojë plotësisht për Korenë e Veriut, Koreja e Veriut nuk do të përpiqet t'i kundërvihet Jugut, dhe paqja në gadishull do të vijë natyrshëm. Ajo që mund të prekë një fëmijë rebel nuk është grushti, apo forca fizike. Është fuqia e dashurisë, që buron natyrshëm nga thellësia e zemrës. Më shumë sesa oriz, apo plehra kimike, është e rëndësishme që ne t'i japim dashuri Koresë së Veriut. Nuk duhet të harrojmë kurrë, se vetëm atëherë kur ne marrim në konsideratë situatën e Koresë së Veriut dhe jetojmë për hir të saj me një zemër të sinqertë dhe të dashur, Veriu do të na hapë zemrën neve dhe gjithë botës.

faqe bosh